




| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery | 13 - 12 2022 | 2 | viti god year |
| Organ/Njësia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SAMSHIL | 8022/2022 | | 116 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.947/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.947/2022 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.947/2022 e datës 25.10.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.870 i datës 07.10.2022, i Komisionit Vlerësues të Komunës së Fushë Kosovës si dhe Njoftimi Nr.856 i datës 03.10.2022 për rezultatet e vlerësimit i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës.

A r s y e t i m

Komuna e Fushë Kosovës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 16.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 06.06.2022 ka shpallur për aplikim konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Punëve Sociale me numër të referencës RN00009035 lidhur me pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1" në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Qendra për Pune Sociale, për klasën e pozitës Profesional 3.

Ankuesja me datën 15.06.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në renditjen perfundimtare të kandidatëve të Komisionit të vlerësimit, e gjeneruar tek SIMBNJ me datën 07.10.2022, e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 50.2 pikë, duke u renditur e njëmbëdhjeta (11) në listën perfundimtare.

E pa kënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit-CV-së (biografisë) nga ana e komisionit të vlerësimit, ankuesja ka parashtruar ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, përmes sistemit elektronik HIRMS, me pretendimet ankimore se e njëjta nuk është vlerësuar në këtë fazë të vlerësimit nga ana e komisionit me pikët maksimale edhe pse i plotëson të gjitha kriteret sipas shpalljes së procedurës së lartcekur.

Me datën 07.10.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Fushë Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.870, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar dhe e ka lënë në fuqi njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore me numër Nr.856 të datës 03.10.2022 lidhur me rezultatet e vlerësimit perfundimtare të kandidatëve të sukseshëm.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e komisionit të vlerësimit në Komunën e Fushë Kosovës, lidhur me refuzimin e ankesës së saj, me datën 25.10.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6440/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se nuk është bërë vlerësimi i jetëshkrimit apo CV-së (biografisë), në mënyrë të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit ngase sipas saj e njëjta i plotëson të gjitha kriteret e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 27.10.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa me datën 10.11.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Fushë Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 06.12.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.181/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot.6440/2022 të datës 25.10.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.11.2022 nga Komuna e Fushë Kosovës, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Konkursin me numër të referencës RN00009035 të datës 16.05.2022; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Listën e ngushtë të aplikantëve pas afatit të ankesave të datës 13.07.2022; Listën e ngushtë të aplikantëve pas verifikimit paraprak të datës 04.07.2022; Vendimin me numër protokollit 770 të datës 05.09.2022 për themelimin e komisionit të vlerësimit; Akt Emërimin me numër protokollit 878 të datës 21.07.2016; Akt Emërimin me numër protokollit 820 të datës 14.07.2016; Akt Emërimin me numër protokollit 913 të datës 22.07.2016; Akt Emërimin me numër

protokolli 1267 të datës 23.08.2017; Vendimin me numër protokoll 578 të datës 13.07.2022 lidhur me caktimin e nëpunëses N.F. si ushtruese e detyrës së Menaxherit të Personelit; Njoftimin me numër 865 të datës 03.10.2022 mbi rezultatin e vlerësimit të kandidatëve të suksesshëm; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 07.10.2022, e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin me numër protokoll 870 të datës 07.10.2022 nga Komisioni i pranimit; Ankesën e ankueses të datës 28.09.2022 e parashtruar tek Komuna e Fushë Kosovës; Aplikacionin e kandidates N.H. të datës 20.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e patentë shoferit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidatit B.B. të datës 06.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e patent shoferit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates H.Q. të datës 18.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates M.K. të datës 20.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates-ankueses A.M.RR të datës 15.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates F.Z. të datës 09.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates B.S. të datës 13.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit L.Sh. të datës 14.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates D.Z. të datës 17.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga Gjykata; Aplikacionin e kandidates G.A.G të datës 07.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga gjykata.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist të Punëve Sociale”, në Komunën e Fushë Kosovës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00002786 lidhur me pozitën “Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Qendra për Punë Sociale, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti i Psikologjisë, Administratë Publike, Pedagogjisë, Sociologjisë, Juridik dhe Punë Sociale.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se për pozitën e lartcekur kanë aplikuar tridhjetë e katër (34) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë njëzet e pesë (25) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesja nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 50.2 pikë gjithsejtë dhe se e njëjta është vlerësuar nga Komisioni i pranimit

në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: " 1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit/CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë", ndërsa pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses se e njëjta nuk është vlerësuar meritore dhe i është bërë diskriminim nga ana e Komisionit të vlerësimit, Kolegji ka konstatuar se ky pretendim është i pa bazuar dhe jo ligjor, pasi që në rastin konkret ankuesja me datën 07.10.2022 sipas Renditjes perfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ, është njoftuar lidhur me rezultatet e vlerësimit për pozitën e lartcekur, e cila ka fituar pikët e përgjithshme prej gjithsejtë 50.2 pikë, duke u renditur e njëmbëdhjeta (11) në listën perfundimtare të këtij njoftimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale tek vlerësimi i CV-së, pasi që sipas saj tek pjesa e përvojës së punës edhe pse një gjë e tillë nuk është kërkuar me konkurs, i janë kërkuar dokumentet që e mbulojnë këtë fushë dhe se e njëjta thekson se i ka dorëzuar dokumentet lidhur me përvojën e punës. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafit 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: "1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet", ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit në bazë të listës mbi Renditjen perfundimtare të kandidatëve të datës 07.10.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ, ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët, me ç' rast ankuesen e ka vlerësuar me 10.2 pikë, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor ku ankuesja deklaroi se edhe pse nuk është kërkuar me konkurs përvoja e punës, i kishte dorëzuar dokumentacionin lidhur me këtë fushë pasi që sipas saj i kanë kërkuar një gjë të tillë, Kolegji ka analizuar dosjen e ankueses e dorëzuar me rastin e aplikimit, ku e njëjta si dëshmi të përvojës profesionale ka dorëzuar: Diplomën me numër Nr.4507 të datës 04.04.2016, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ka marrë titullin Bachelor i Sociologjisë; Diplomën me numër Nr.1208 të datës 11.02.2019, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet master në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ka marrë titullin Master i Sociologjisë, si dëshmi mbi përvojën e punës ka dërguar shkresën lidhur me përvojën e punës si verifikim punësimi e lëshuar nga IDRA Research and Consulting-Kosova, sipas se cilës ankuesja nga viti 2018 deri në vitin 2019 ka punuar si anketuese në terren në bazë të projekteve aktive të kohëpaskohshme, letër rekomandimin e datës 14.07.2020, të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, sipas së cilës ankuesja ka kryer praktiken në këtë drejtori për periudhën prej gjashtë muajsh ku theksohet edhe fakti se gjatë kësaj kohe ka qenë e angazhuar edhe me kontratë për shërbime e veçanta, ndërsa për fushën e trajnimeve e njëjta nuk ka paraqitur dëshmi që mbulon këtë pjesë dhe ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, sepse ankuesja sipas dëshmive të dorëzuara del se është vlerësuar edhe për fushën e përvojës profesionale dhe atë të punës (edhe pse sipas kriterit të konkursit e njëjta nuk

është kërkuar), ku ka arritur të marrë gjithsejtë 10.2 pikë, ndërsa për fushën e trajnimeve e njëjta meqenëse nuk ka dorëzuar dëshmi që e mbulon këtë fushë, edhe nuk është vlerësuar, andaj Kolegji vlerëson se Komisioni i Pranimi në rastin konkret vlerësimin për këtë pjesë e ka bërë në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 4 nën paragrafit 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë edhe pretendimet ankimore të ankueses lidhur me këtë pjesë janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës, me datën 03.10.2022 ka publikuar Rezultatet e vlerësimit lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, për grupin e pozitive „*Specialist të Punëve Sociale*” lidhur me pozitën “Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1”, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/Qendra për Punë Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, për klasën e pozitës Profesional 3, në të cilën janë përfshirë emrat e kandidatëve sipas pikëve të arritura dhe të përzgjedhur në bazë të pikëve si në vijim: B. B me gjithsejtë 87.6 pikë të arritura dhe H. Q me gjithsejtë 73.8 pikë të arritura, andaj ndërlidhur me këtë, Kolegji konstaton se publikimi nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Komunës të Fushë Kosovës, është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se : **“2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”**, dhe në këtë kuptim ankuesja është renditur e njëmbëdhjeta (11) në këtë listë me gjithsejtë 50.2 pikë të arritura, e që bazuar në dispozitën e lartcekur e njëjta nuk ka arritur të mbledh pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur në radhët e kandidatëve fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Fushë Kosovës lidhur me dosjet e kandidatit të përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekur dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimi me rastin e përzgjedhjes së kandidatit B.B, i cili ka grumbulluar pikë më së shumti në raport me kandidatët e tjerë, për grupin e pozitive „*Specialist të Punëve Sociale*” lidhur me pozitën “Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1”, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/Qendra për Punë Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, për klasën e pozitës Profesional 3, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se:” neni 24. **Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit** “. Ndërsa ndërlidhur me dëshmitë e dorëzuara të dosjes së kandidatit të përzgjedhur nga kjo procedurë e rekrutimit, Kolegji ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur B.B posedon Diplomën me numër Nr.909 të datës 08.06.2009, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik me datën 04.12.2008 dhe ka marrë titullin Bachelor i Filozofisë, po ashtu i njëjti posedon Diplomën me numër Nr.686 te datës 01.06.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet master në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë me datën 23.05.2016 dhe ka marrë titullin Master i Sociologjisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës së kandidatit të përzgjedhur, Këshilli nuk është lëshuar në shqyrtim te dosjes se tij lidhur me këtë pjesë, meqenëse nuk është kërkuar me konkurs lidhur me pozitën e lartcekur. Andaj ndërlidhur me këtë, Kolegji konstaton se kandidati i përzgjedhur B.B i plotëson kushtet e konkursit lidhur me pozitën e lartcekur për fushën e arsimit të caktuar, ngase i njëjti ka ofruar dëshmi se posedon diplomën

lidhur me përfundimin e studimeve themelore dhe master nga fusha e cila është kërkuar me konkurs.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunën e Fushë Kosovës, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas Njoftimit me numër Nr.856 të datës 03.10.2022 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për emrin e grupit „Specialist të Punëve Sociale”, në Komunën e Fushë Kosovës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00002786 lidhur me pozitën “Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Qendra për Punë Sociale për klasën e pozitës Profesional 3, si dhe Vendimi me numër Nr.870 i datës 07.10.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Fushë Kosovës, kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, bazuar në pretendimet e ankuesit si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.947/2022, datë 13/12/2022.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.